



**REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI**

---

**C.nr.1127/12**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Arsim Hamzaj, me sekretaren juridike Majlinda Shala, në kontestin e paditësit KEK – Distrikti në Prizren, kundër të paditurit Y. G. nga Prizreni, rr... nr..., për shkak të borxhit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 28.04.2015, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia** e paditësit KEK – Distrikti në Prizren dhe **detyrohet** i padituri Y. G. nga Prizreni, që paditësit në emër të borxhit për shfrytëzimin e energjisë elektrike t'ia paguajë shumën e të hollave në vlerë prej **3,101.33** euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**II.** Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit KEK – Distrikti në Prizren, mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën **I** të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e përgjithshme të kërkuar prej 3,331.17 euro, **refuzohet si e pa bazuar**.

**III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Tani paditësi (ish kreditori) KEK – Distrikti në Prizren, me datën 22.04.2009, pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozim për përmbarim në bazë të dokumentit autentik, kundër tani të paditurit (ish debitorit) Y. G. nga Prizreni, rr... nr..., për shkak të pagesës së borxhit. Me datën 27.04.2009, gjykata ka marr aktvendimin E.nr.694/09, për caktimin e përmbarimit të propozuar.

Kundër aktvendimit për përmbarim E.nr. 694/09, të datës 27.04.2009, i padituri (ish debitor) Y. G. kishte parashtruar kundërshtim, duke e atakuar të njëjtin me arsyetimin se nuk ka mundësi që ta paguajë këtë borxh, pasi që askush në familjen e tij nuk punon dhe për këtë ka pasur vonesa në pagesën e disa faturtave, me propozim që kundërshtimi i tij të aprovohet dhe që aktvendimi i atakuar të lihet jashtë fuqie, si dhe duke propozuar pezullimin e ekzekutimit të caktuar me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren E.nr. 694/09, të datës 27.04.2009.

Duke vendosur sipas kundërshtimit të të paditurit (ish debitorit), me datën 04.12.2012, kjo gjykatë në procedurë përmbarimore ka marrë aktvendim përmes të cilit është shfuqizuar aktvendimi për lejim të përmbarimit E.nr.694/09, të datës 27.04.2009, ndërsa që propozimi për ekzekutim i kreditorit, është konsideruar padi.

Seanca e shqyrtimit kryesor në lidhje me këtë çështje juridike është mbajtur me datë 28.04.2015.

Në këtë seancë, i autorizuari i paditësit B. P. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkespadiës, duke kërkuar nga gjykata që kërkespadinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe ta obligojë të paditurin që në emër të borxhit, t'ia paguajë paditësit shumën në lartësi prej 3,331170 eurove. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar por të njëjtat nuk i ka specifikuar.

I padituri në seancën e shqyrtimit kryesor ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se ka pasur problem me njehsorin elektrik për shkak të një defekti dhe për këtë ka dërguar në qendrën e kalibrimit në Prishtinë, ku është konstatuar defekti, mirëpo i është hequr nga faturat një shumë e vogël e borxhit ndërsa në fjalën e fundit i ka propozuar refuzimin e kërkesëpadiës si të pabazë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat e propozuara si në vijim: Faturën nr. DPZ.5192963, të lëshuar nga KEK – Prizren, të datës 03.03.2009; transaksionet e konsumatorit të lëshuar nga KEK – Prizren, të datës 22.11.2012 si dhe transaksionet e konsumatorit të lëshuar nga KEDS Prizren, të datës 27.02.2015.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadija e paditësit është e **bazuar**.

Nga leximi i Faturës nr. DPZ.5192963, të lëshuar nga KEK – Prizren, të datës 03.03.2009, gjykata ka konstatuar se kjo faturë është lëshuar në emër të Y. G. nga Prizreni ( këtu të paditurit) dhe se sipas kësaj fature, borxhi i përgjithshëm del të jetë në shumën prej 3,331.17 euro.

Nga leximi i transaksioneve të konsumatorit të lëshuar nga KEK - Prizren, të datës 22.11.2012, gjykata ka konstatuar se borxhi i përgjithshëm i këtu të paditurit për këtë periudhë është në shumën prej 3,022.67 euro.

Nga leximi i transaksioneve të konsumatorit të lëshuar nga KEDS - Prizren, të datës 27.02.2015, gjykata ka konstatuar se borxhi i përgjithshëm i këtu të paditurit deri më këtë datë është në shumën prej 3,101.33 euro.

Me nenin 17 Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është e paraparë se *“pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*, ndërsa me nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se *“kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje*

*krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij*”. Po ashtu me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se “ **palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla**”, ndërsa që me nenin 7.2 të po këtij ligji decidivisht ceket se “Gjykata është e autorizuar që t’i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur, si dhe t’i marrë provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3 par.3 të këtij ligji)...”.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, është provuar se këtu i padituri Y. G., ka detyrime-borxh, ndaj paditësit KEK. – Distrikti në Prizren për periudhën kontestuese shumë prej 3,101.33 euro. Në bazë të provave të administruara del se ky borxh evidentohet në emër të të paditurit Y. G. nga Prizreni dhe në bazë të këtyre provave del se borxhi i të paditurit për periudhën kontestuese është në lartësi prej 3,101.330 euro, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Andaj, duke u bazuar në gjendjen e këtyre faktike të vërtetuar, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar, si në pikën **I** të dispozitivit.

Pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit përtej shumës së aprovuar, gjykata e refuzoi, ngase gjeti se e njëjta është e pabazuar. Kjo ngase në bazë të provave të administruara, e sidomos transaksioneve të konsumatorit është vërtetuar se borxhi i përgjithshëm i të paditurit është në shumë prej 3,101.33, e jo siç është cekur në kërkesëpadi, edhe pasi që paditësi nuk ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, andaj gjykata vendosi si në pikën **II** të dispozitivit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.4 të LPK-së, pasi që i autorizuari i paditësit i ka kërkuar shpenzimet por nuk i ka specifikuar, ndërsa i padituri nuk i ka kërkuar.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.1127/12, datë 28.04.2015**

Sekretarja juridike  
Majlinda Shala

**Gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.